



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

# DITARI JAVOR

8-14 Prill 2019

## INVESTIMET NË SHËNDETËSI

## PROGRAMI I 300 QENDRËN SHËNDETËSORE

## QENDRAT SHËNDETËSORE VERORE

## INVESTIME NË MATERNITETE

## SHËRBIME SOCIO- SHËNDETËSORE NË KOMUNITET

## FINANCIM NDËRMARRJEVE SOCIALE

## “INICIATIVA E DIMENSIONIT SOCIAL”

Brenda muajit Qershor pritet të përfundojnë punimet për ndërtimin e spitalit të ri Kirurgjikal në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Një investim prej 8.8 milionë euro që do të transformojë shërbimin e kirurgjisë në qendrën më të madhe spitalore në vend. Spitali i ri kirurgjikal do të ketë: 120 shtretër; 7 salla operacioni; njësi terapie intensive; laborator histologjik; salla studimi dhe ambiente ndihmëse për studentët.

Rehabilitohet Qendra Shëndetësore Tregan në Elbasan, e cila ofron sot një standard të ri shërbimi për 5 mijë banorë të kësaj zone. Programi 300 Qendrave Shëndetësore garanton kushte të përmirësuara të infrastrukturës por edhe shërbime të integruara, me programet e parandalimit, programet e shëndetësisë elektronike dhe shërbime cilësore në kujdesin shëndetësor parësor.

Rehabilitohet Ambulanca e Kaninës në Vlorë, e cila ofron sot kushte më të mira pune për stafin mjekësor dhe një standard të ri shërbimi për 2500 banorë por edhe turistët që kanë nevojë për kujdes shëndetësor. Me programin e rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore, prioritet i këtij viti do të jetë rehabilitimi i qendrave shëndetësore pranë zonave turistike.

Në maternitetin “Koço Gliozheni” në Tiranë janë shtuar 5 inkubatorë të rinj, falë bashkëpunimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me biznesin. Vijnë investimet me synim përmirësimin e kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën. Pas ndërtimit të dy materniteteve, të Sarandës dhe Korçës, këtë vit nisin investimet në maternitetin e Kukësit, të Beratit, të Lezhës dhe më pas, edhe në maternitetet e Matit dhe Pogradecit.

Në Ditën Ndërkombëtare të Romëve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpalli fushatën e ofrimit të shërbimit social dhe shëndetësor në komunitetin Rom dhe Egjiptian. Ky program vijon për dy vitet radhazi, për të garantuar akses në shërbime për grupet vulnerabël. Gjatë vitit 2018 janë kryer 1 mijë vaksinime; 200 mamografi dhe eko; 96 vizita okulistike dhe syze falas.

Mundësi punësimi për personat me aftësi të kufizuara, gratë me ndihmë ekonomike dhe të gjithë grupet e pafavorizuara të shoqërisë, me financimin e ndërmarrjeve sociale nga shteti. Të gjitha organizatat jo-fitimprurëse mund ta aplikojnë për të marrë statusin e Ndërmarrjes Sociale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konferenca “Iniciativa e Dimensionit Social” e organizuar në Tiranë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me organizatën gjermane ASB, dërguar nga eurodeputeti z. Knut W. Fleckenstein, u fokusua tek përfshirja më e madhe e të rinjve, shoqërisë civile dhe të strukturave vendore, në thithjen e projekteve konkrete të zhvillimit, për të përshpejtuar rrugën drejt integritimit evropian të Shqipërisë, pa lënë askënd pas.